



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUDSKI SAVET KOSOVA KOSOVO JUDICIAL COUNCIL	01 / 388
DATËT	14. 04. 2023
PRISHTINË - A	

**KGJK.nr.145/2023**

**Datë: 6 prill 2023**

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7, paragrafi 1, pika 1.14, të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Enes Mehmeti, gjyqtar në Gjykatën e Apelit, Ilir Bytyqi, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe Arben Hoti, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, sipas raportit të panelit hetimor për rastin Nr.AD/KGJK/19/2022/ GJA - ADGJA.nr.11/22, me të cilin rast Këshilli ka bashkuar edhe rastet AD/KGJK/03/2023/GJTHFR-AD.nr.16/23 dhe AD/KGJK/01/2023/GJTHPR-AD/GJTHPR/42/23, të datës 10 mars 2023, në pajtim me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nenin 19 dhe 20 të Rregullores 05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në seancën dëgjimore të mbajtur me datë 6 prill 2023, nxjerr këtë:

## V E N D I M

**Enes Mehmeti**, gjyqtar në Gjykatën e Apelit, **Ilir Bytyqi**, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe **Arben Hoti**, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, nuk janë përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafët 2.9 dhe 2.15, të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

## A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (më tutje Këshilli) ka pranuar nga Autoriteti Kompetent kërkesë për fillimin e hetimit disiplinor me pretendim se Enes Mehmeti, gjyqtar në Gjykatën e Apelit, mund të ketë kryer shkelje disiplinore nga neni 5, paragrafi 2, nën paragrafët 2.9 dhe 2.15, të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Autoriteti Kompetent, kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor, e ka bazuar në emailin e Kryetarit të Gjykatës Supreme z.Enver Peci, të datës 16.11.2022, si dhe në emisionin Betimi për Drejtësi, të titulluar “Ndikimi në rastin Brezovica”, duke pretenduar se gjyqtari Enes Mehmeti ka kryer shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafët 2.9 dhe 2.15, të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe ka kërkuar nga Këshilli që të themelohet paneli hetimor. Kërkesës për fillimin e hetimit disiplinor Autoriteti Kompetent i’a ka bashkangjitur publikimet në portalin Betimi për Drejtësi, emalin zyrtar të Gjykatës së Apelit, lidhur

me pyetjen e gazetarit emalin e prokurorit Rasim Maloku, të datës 4.10.2022,  
shënimin zyrtar të datës 26.10.2022, nga deklaratën e datës 17.11.2022, e zyrtares  
emalin e Kryetarit të Gjykatës Supreme Enver Peci, i datës 16.11.2022, lejen e  
vizitës të datës 24.10.2022 dhe deklaratën e të datës 17.11.2022.

Me tutje, Autoriteti Kompetent ka propozuar që ndaj subjektit të hetimit, në rast se vërtetohet se ekziston shkelja disiplinore, t'i shqiptohet njëri nga sanksionet disiplinore adekuate të parapara sipas nenit 7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Këshilli me vendimin KGJK.nr.463/2022, të datës 24 nëntor 2022, ka themeluar panelin hetimor për rastin disiplinor Nr.AD/KGJK/19/2022/ GJA - ADGJA.nr.11/22.

Në këtë periudhë, konkretisht me datë 04.01.2023, Këshilli ka pranuar nga Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë kërkesë për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit Arben Hoti, duke pretenduar se gjyqtari Hoti, siç është prezantuar në emisionin Betimi në Drejtësi, të titulluar "Ndikimi në rastin Brezovica", në mes tjerash nga prokurori i rastit është pretenduar se gjyqtari Hoti përmes disa gjyqtarëve tjerë ka ndikuar që të lëshohet leje për vizitë për të pandehurin L.V, në kundërshtim me rregullat e Qendrës së Paraburgimit në Gjilan.

Lidhur me situatën e njëjtë, Këshilli me datë 10.01.2023, ka pranuar nga Autoriteti Kompetent konkretisht nga nënkryetarja e Gjykatës Themelore në Ferizaj, kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit Ilir Bytyqi, të bazuar në emisionin Betimi në Drejtësi, të titulluar "Ndikimi në rastin Brezovica".

Këshilli në mbledhjen e mbajtur me datë 18.01.2023, duke i shqyrtuar kërkesat e lartcekura të pranuar nga Autoritetet Kompetente, konstatoj se edhe pse nuk kemi të bëjmë me subjekte të njëjta të hetimit disiplinor por shkelja disiplinore e pretenduar, si në aspektin e gjendjes materiale ashtu edhe në kualifikimin juridik janë të njëjta, prandaj vendosi të bashkoj procedurën disiplinore me panelin hetimor të themeluar me vendimin KGJK.nr.463/2022, të datës 24 nëntor 2022, e gjithë kjo me qëllim të efikasitetit dhe ekonomizmit të procedurës.

Paneli hetimor me datë 14 mars 2023, i ka paraqitur Këshillit raportin me shkrim mbi faktet dhe provat e mbledhura lidhur me hetimin e bërë për shkeljet e pretenduara për tri subjektet e hetimit disiplinor.

Me datë 6 prill 2023, Këshilli ka mbajtur seancë dëgjimor, ku morën pjesë Kryesuesja e panelit hetimor gjyqtarja Violeta Husaj Rugova dhe subjektet e hetimit gjyqtarët Enes Mehmeti, Ilir Bytyqi dhe Arben Hoti.

Kryesuesja e panelit hetimor në seancën dëgjimore pranë Këshillit deklaroj se bazuar në Ligjin 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 24 shkurt 2023 ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën ka prezantuar subjektet e hetimit disiplinor gjyqtarët Enes Mehmeti, Ilir Bytyqi dhe Arben Hoti. Në këtë seancë paneli ka dëgjuar zyrtarisht dëshmitarët zyrtare ligjore, gjyqtar dhe bashkëpunëtorë në Gjykatën Themelore në Ferizaj. Nga te gjitha provat materiale të administruara nga paneli hetimor në këtë çështje disiplinore, të cilat kanë qenë në përputhje të plotë me deklaratën me shkrim të gjyqtarit

dhe nga deklaratat e subjekteve të hetimit, paneli ka ardhur në këto konkluzione: se subjekti i hetimit Enes Mehmeti përmes telefonit ka kontaktuar me motrën e të pandehurit që ndodhej në paraburgim L.V, dhe e njëjta ishte interesuar për të marrë një leje vizitë për ta vizituar vëllain e saj dhe e kishte pyetur për procedurën. Subjekti i hetimit Enes Mehmeti motrën e të pandehurit që ka qenë në paraburgim, e ka njohur sepse ka qenë mësuesja e vajzës së tij.

Më tutje, subjekti i hetimit Enes Mehmeti pas kësaj kishte kontaktuar me subjektin e dytë të këtij hetimi disiplinor gjyqtari Ilir Bytyqi, e kishte pyetur lidhur me procedurën e lëshimit të lejes së vizitës në paraburgim. Pasi kishte marrë sqarimin lidhur me lëshimin e lejes së vizitës në paraburgim subjekti i hetimit Enes Mehmeti e kishte telefonuar motrën e të paraburgosurit Vitija dhe i kishte treguar se duhet të shkojë në Gjykatën Themelore në Ferizaj për të aplikuar për leje. Në këtë situatë, kur motra e të pandehurit kishte shkuar në Gjykatën Themelore në Ferizaj, dhe kishte kërkuar lejen për vizitë të vëllait të saj i cili ndodhej në paraburgim, zyrtarja e gjykatës i kishte komunikuar se nuk mund të lëshohet leja, sepse leja para dy dite ishte konsumuar nga një anëtar tjetër i familjes. Tutje i kishte thënë zyrtares së gjykatës se e kishte dërguar gjyqtari Enes.

Nga paneli është vërtetuar se subjekti i dytë i këtij hetimit gjyqtari Ilir Bytyqi, kishte shkuar në zyrën e zyrtares ligjore dhe e kishte pyetur se a po lëshohet leja. E njëjta i kishte thënë se “a të dërgoj edhe ty gjyqtari Enes a”, mirëpo gjyqtari Ilir Bytyqi ishte përgjegjës se nuk e kishte dërguar gjyqtari Enes por gjyqtari Arben. Paneli hetimor për subjektet e hetimit Ilir Bytyqi dhe Arben Hoti, nuk kanë gjetur prova se njiheshin me motrën e të paraburgosurit L.V, dhe për kontaktin më të njëjtën. Në fund të fjalës hyrëse Kryesuesja e panelit hetimor deklaroi se qëndron pranë të gjitha të gjeturave të panelit hetimor, të paraqitura në piken 4, të raportit mbi faktet dhe provat e mbledhura.

Në këtë seancë dëgjimore subjekti i hetimit gjyqtari Enes Mehmeti ka deklaruar se nga gjyqtari Ilir Bytyqi ka kërkuar vetëm sqarim për procedurën e lëshimit të lejes, i njëjti ka pranuar se e cila e kishte kërkuar lejen e vizitës për vëllain e saj është mësuesja e vajzës së tij.

Subjekti i dytë i këtij hetimi gjyqtari Ilir Bytyqi, para Këshillit deklaroi se nuk ka ndikuar në lëshimin e lejes dhe se komunikimi me zyrtaren ligjore të gjykatës ka ardhur si pasojë e faktit se edhe ky e kishte një lëndë të të pandehurit L.V që ndodhej në paraburgim, dhe ishte thirrur nga zyrtaret e gjykatës prej recepcioni, për të pyetur për lëshimin e lejes së vizitës. I njëjti kishte sqaruar se lënda kontestuese për të cilën kërkohej leja e vizitës ndodhej të një gjyqtar tjetër i kësaj gjykate. Me tutje, subjekti i hetimit gjyqtari Ilir Bytyqi deklaroi se në korridor e kishte takuar zyrtaren ligjore dhe e kishte pyetur se a ishte lëshuar leja. Nga e njëjta kishte marrë përgjigje se leja nuk do të lëshohet sepse është konsumuar para dy dite nga një anëtar tjetër i familjes. Në lidhje me këtë situatë subjekti i hetimit gjyqtari Ilir Bytyqi ka deklaruar se gjyqtari Enes e kishte thirrur dy herë, një herë për ta pyetur se si lëshohet leja dhe një herë tjetër për ta pyetur pse nuk ishte lëshuar leja.

Subjekti i tretë i këtij hetimi, gjyqtari Arben Hoti deklaroi para Këshillit se qëndron pranë deklaratës që e ka dhënë para panelit hetimor. Për këtë çështje, gjyqtari Hoti deklaroi se fillimisht është kontaktuar nga një gazetare e cila e kishte pyetur lidhur me ndikimin në rastin Brezovica. Nga e njëjta gazetare ishte pyetur prapë se e din që nuk e ka rastin por a ka ndikuar në këtë rast. Para Këshilli subjekti i hetimit gjyqtari Hoti theksoj se nuk ka konfidencë me gjyqtarin Ilir Bytyqi dhe as me gjyqtarin Ibrahim Idrizi, se nuk merret me asnjë lëshim të lejes, dhe nuk ka kërkuar

asnjëherë nga askush që të lëshohet leje për vizitë në paraburgim dhe as nga gjyqtari Ibrahim Idrizi. Nuk ka të bëjë asgjë më këtë rast, është i befasuar se si është i përfshirë në këtë situatë, më shumë këtë rast e sheh si protagonistizëm nga ana e prokurorit të rastit por edhe të zyrtares ligjore të Gjykatës Themelore në Ferizaj

Në fjalën përfundimtare Kryesuesja e panelit hetimor deklaroj se qëndron pranë të gjeturave të paraqitura në raportin me shkrim mbi faktet dhe provat e mbledhura dhe se nuk ka asgjë tjetër se çka të shtoj.

Ndërsa subjekti i hetimit gjyqtari Enes Mehmeti, në fjalën përfundimtare deklaroj se nuk ka se çfarë të shtoj me tepër përpos asaj çka ka deklaruar para panelit hetimor dhe gjatë kësaj seance në Këshill. Sipas tij i gjithë komunikimi me gjyqtarin Ilir Bytyqi ka qenë për të sqaruar procedurën sa i përket lëshimit të lejes së vizitës, për të vizituar familjaret një të paraburgosur, dhe se me këtë komunikim me gjyqtarin Bytyqi nuk ka shkelur Kodin e Etikës Profesionale për gjyqtar.

Në vazhdim të fjalës përfundimtare subjekti i dytë i këtij hetimi gjyqtari Ilir Bytyqi deklaroj se nuk ka bërë asnjë shkelje disiplinore dhe se i gjithë komunikim lidhur me këtë situatë ka qenë për të sqaruar se cili gjyqtar duhet ta lëshoj lejen e vizitës, pasi që për të njëjtin të paraburgosur ka pasur lëndë edhe ai dhe një gjyqtar tjetër i kësaj gjykata. Nuk ka ndikuar në lëshimin e kësaj leje, por ka qenë më shumë sqarim se cili gjyqtar duhet ta lëshoj këtë leje dhe kërkoj nga Këshilli që të lirohet nga përgjegjësia disiplinore.

Subjekti i hetimit gjyqtari Arben, në fjalën përfundimtare deklaroj se nuk ka çka të shton më tepër, duke theksuar se edhe gjyqtari Ilir deklaroj këtu në seancë dëgjimore që nuk më njeh dhe se gjatë komunikimit për këtë rast me zyrtaren ligjore të gjykatës Q.B nuk ma ka përmend emrin tim.

Për të vërtetuar faktet në këtë çështje disiplinore, Këshilli i administroj këto prova: Raportin me shkrim mbi faktet dhe provat e mbledhura te panelit hetimor; Kërkesat për fillimin të hetimit disiplinor për te tre subjektet e hetimit disiplinor; E-maili i Kryetarit te Gjykatës Supreme drejtuar Valon Totaj, dhe Albina Shabani; Leja e vizite e lëshuar me dt. 24.10.2022, për dhe për ta vizituar të paraburgosurin E-mail i shkëmbyer në mes të dhe kryesuesit Albert Zogaj i datës 03.10.2022, te njëjtën ditë edhe anasjelltas, E-mili i dt. 04.10.2022; Pesë E-mail të subjektit të hetimit Enes Mehmeti të datës 15.11.2022 dhe 17.11.2022; Publikimi i artikullit në emisionin Betimin për Drejtësi i datës 11.12.2022, rasti Brezovica i raportuar nga . Përgjigja e subjektit te hetimit Enes Mehmeti e drejtuar kryesueses se panelit hetimor; Kërkesën për informata e datës 11.11.2022; Korrespondenca me E-mail në mes te Enes Mehmeti dhe . dt.11.11.2022, si dhe i të njëjtës datës Enes Mehmeti dhe Mustaf Tahiri, edhe përmes Mirlinda Rexhepi; Përgjigja nënkryetares se Gjykatës Themelore në Prizren Majlinda Bytyqi Rexhepi për Enes Mehmeti i dt. 22.11.2022; Shkresa e Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë drejtuar kryesuesit Albert Zogaj e datës 27.12.2022; Korrespondenca ne përmes E-mail adresës në mes të Arben Hoti dhe të datës 09.12.2022 dhe 08.12.2022; Përgjigje-deklarata nga gjyqtari Arben Hoti për kryetaren e Gjykatës Themelore në Prishtinë Albina Shabani- Rama e dt. 09.12.2022; Përgjigja-deklarata e gjyqtarit Ilir Bytyqi për nënkryetaren e gjykatës Themelore ne Ferizaj Mirlinda Bytyqi Rexhepi dt.06.12.2022; Korresnodenca nëpërmes E-mail adresës Kastriot Makolli dhe Arben Hoti e datës 08.12.2022; dhe e datës 23.11.2022; Deklarata e e datës 17 nëntor 2022; Deklarata e zyrtares e datës 17.11.2022; Shënimi zyrtar i zyrtares Qëndresa

Bobi, i dt. 26.10.2022; Aktakuza *PP/l.m. 99/2017*, te datës 16.11.2020, ku janë 11 të akuzuar përfshirë edhe L.V. dhe rezulton se në sistemin smil lënda mbanë numrin 2020: 152580 lënda i është caktuar Ilir Bytyqi 16.11.2020; Aktvendimi mbi caktimin e paraburgimit i dt. 27.09.2020, ku janë 6 të pandehuri në mesin e tyre edhe L.V. dhe CD video incizimi nga emisioni Betimi për Drejtësi.

Këshilli nga provat e administruara gjatë seancës dëgjimore, nuk ka gjetur ndonjë provë për të vërtetuar që në veprimet e subjektit të hetimit disiplinor gjyqtarit Enes Mehmeti lidhur me situatën kontestuese, për të cilën Autoriteti Kompetent ka pretenduar se me komunikimet e tija me gjyqtarin Ilir Bytyqi mund të ketë kryer shkelje disiplinore, të përcaktuara në nenin 5-shkelje disiplinore për gjyqtar, paragrafi 2-shkelje të detyrave të gjyqtarit, sipas këtij ligji, përfshin veprimet e mëposhtme, në çoftë se gjyqtari i kryen me dashje ose nga pakujdesia e rëndë, nën paragrafët 2.9-nderhyn në veprimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve të tjerë më qëllim të ndikimit në aktivitete dhe vendimet e tyre në çfarëdo mënyre të ndaluar me ligj, dhe 2.15-përfshihet në sjellje, çoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës ose mundë të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmëri ose besueshmërinë e gjyqësorin, të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Sipas vlerësimit të Këshillit komunikimi i zhvilluar në mes të gjyqtarit Enes Mehmeti dhe Ilir Bytyqi ka qenë komunikim i kërkuar nga gjyqtari Mehmeti për të sqaruar procedurën se ku duhet të kërkohet leja për të vizituar të paraburgosurit. Në bazë ta analizimit të provave, Këshilli nuk gjeti ndonjë qëllim tjetër. Nga të gjeturat e Këshillit subjekti i hetimit gjyqtari Enes Mehmeti, ishte kontaktuar nga motra e të pandehurit L.V. i cili ka qenë në paraburgim në rastin “Brezovica”, e që ka qenë mësuesja e vajzës së tij, për ta pyetur se ku duhet të kërkohet leja për ta vizituar vëllain e saj që ka qenë në paraburgim. Siç ka deklaruar gjyqtari Enes Mehmeti edhe të paneli hetimor edhe gjatë seancës në Këshill, e kishte thirrur në telefon gjyqtarin Ilir Bytyqi për ta pyetur se si duhet të merret leja për të vizituar të paraburgosurit. Pasi kishte marrë sqarimet lidhur me procedurën e lëshimit të lejes së vizitës nga gjyqtari Ilir Bytyqi, e kishte njoftuar motrën e të paraburgosurit L.V se duhet të shkojë në gjykatë për të aplikuar për leje. Në bazë të provave dhe deklaratës së gjyqtarit Mehmeti, Këshilli gjeti se arsyeje se pse motra e të paraburgosurit e kishte përmendur emrin e gjyqtarit Enes kur ka kërkuar lejen në Gjykatën Themelore në Ferizaj të zyrtarja ligjore

ka qenë vetëm për shkak të informacionit që e kishte marrë nga gjyqtari Enes Mehmeti lidhur me procedurën për aplikim për leje për të vizituar vëllain në qendrën e paraburgimit në Gjilan.

Ndërsa sa i përket pretendimit të Autoritet Kompetent/Nënkryetares së Gjykatës Themelore në Ferizaj se gjyqtari Ilir Bytyqi nga prezantimet e paraqitura në media me temë “Ndikimet në rastin Brezovica” gjatë emisionit është përmendur se ka ushtruar ndikim të zyrtarja për dhënien e lejes për vizitë, mund të ketë kryer shkelje disiplinore, Këshilli nuk gjeti prova për një pretendim të tillë. Subjekti i hetimit gjyqtari Bytyqi në seancën dëgjimore në Këshillë deklaroi se ishte thirrur nga administrata e gjykatës për të pyetur se kush duhet ta lëshoj lejen për rastin kontestues duke pretenduar se lënda me të pandehurin L.V i cili ndodhet në paraburgim dhe për të cilin kërkohet leja për vizitë është të gjyqtari Bytyqi. Me tutje, subjekti i hetimit gjyqtari Bytyqi theksoi se është sqaruar me administratën e gjykatës se këtë lëndë nuk e ka ai për një gjyqtar tjetër, dhe e njoftoj Këshillin se në praktik shpesh lëshojnë leje për vizitë për të paraburgosurit tjerë për të cilët lënda ndodhet tek gjyqtaret tjerë, dhe kjo ndodh kur gjyqtaret tjerë nuk ndodhen në gjykatë.

Nga Këshilli gjithashtu nuk u vërtetua asnjë ndikim tek zyrtarja ligjore përveç qe e kishte pyetur se “a po lëshohet leja, se më ka pyetur gjyqtari Enes për procedurën se qysh lëshohet leja” dhe i njëjti ka pranuar se i kishte thënë zyrtares se në çoftë se nuk ka kushte ligjore nuk duhet të lëshohet. Sipas vlerësimit të Këshillit subjekti i hetimit Ilir Bytyqi nuk ka ndikuar në lëshimin e kësaj leje, por ka qenë më shumë sqarim se cili gjyqtar duhet ta lëshoj lejen për vizitë.

Për subjektin e hetimit gjyqtarin Arben Hoti, Këshilli konstaton se përfshirja e tij në këtë rast disiplinor është e pa bazuar sepse edhe vet gjyqtaret Enes Mehmeti dhe Ilir Bytyqi deklaruan para Këshillit se gjatë komunikimit për këtë situatë kontestuese nuk e kanë përmendur me asnjë zyrtar të Gjykatës Themelore në Ferizaj emrin e gjyqtarit Arben Hoti. Edhe zyrtarja ligjore

në dëshminë para panelit hetimor kur është pyetur se pse e ka përmendur emrin e gjyqtarit Arben Hoti, e njëjta ka thënë se ka përmendur vetëm emrin Arben, siç i kishte thënë gjyqtari Ilir Bytyqi, të cilën gjë gjyqtari Bytyqi para Këshillit e mohoi. Tjetër, Këshilli vërtetoi se edhe pretendimi i zyrtares ligjore se bashkëpunëtori profesional i gjykatës i kishte thënë se “hajt a po e lëshon qat leje se po me shkruan gjyqtari Enes”, nuk qëndron sepse bazuar në dëshminë e dhënë nga bashkëpunëtori profesional z para panelit hetimor, i njëjti ka deklaruar se me përgjegjësi penale, morale dhe profesionale deklaroi se atë personalisht nuk e ka thirrur askush dhe nuk ka kërkuar askush asgjë lidhur me këtë rast.

Këshilli në seancën për këshillim dhe votim me mënyrë unanime konstaton se subjektet e këtij hetimi disiplinor gjyqtaret Enes Mehmeti, Ilir Bytyqi dhe Arben Hoti, nuk janë përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafët 2.9 dhe 2.15, të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sa i përket pretendimit për ndikim në rastin penal të quajtur “Brezovica”, andaj vendosi që t’i liroj nga përgjegjësia disiplinore.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës  
KGJK.nr.145/2023, datë: 6 prill 2023

Albert ZOGAJ  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 15 ditëve nga pranimi i vendimit.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Valon Totaj, Kryetar, Gjykata e Apelit;
- Albina Shabani Rama, Gjykata Themelore në Prishtinë;
- Mirlinda Bytyqi, Nënkrjetare e Gjykatës Themelore në Ferizaj;
- Enes Mehmeti, Gjyqtar, Gjykata e Apelit;
- Ilir Bytyqi, gjyqtar, Gjykata Themelore në Ferizaj; dhe
- Arben Hoti, Gjyqtar, Gjykata Themelore në Prishtinë.